

## DAC\_SPE\_01: Ndikimi i Ankandëve të Dytë

### Shënime:

Vlerësohet se e gjithë procedura e Ankandit të Dytë do të zgjasë rreth 30 minuta (vendimi i NEMO-s, përfshirë rihapjen e librave të urdhërporosive dhe llogaritjen e dytë), të cilat përfaqësojnë ndikimin e vërtetë në kohën normale të Bashkimit të Tregut.

Në rast se Rezultatet e Bashkimit të Tregut nuk konfirmohen si përfundimtare në orën [REDACTED], Komiteti i Incidencës do të deklarojë Ndarjen e Plotë të Bashkimit të Tregut.

## Përmbajtja

1.	Hyrje .....	3
	<i>Tabela 1 – Kufijtë e çmimeve të paracaktuara të aplikueshme në Zonat e Ofertimit të DAC-it.</i>	3
1.1.	Përmbledhje.....	3
1.2.	Qeverisur / Rregulluar nga .....	3
1.3.	Mjetet .....	3
1.4.	Procedurat shoqëruese.....	3
2.	Procedura .....	4
2.1.	Parakushtet për të filluar .....	4
2.2.	Pasqyrë e përgjithshme.....	4
	<i>Tabela 2 – Procesi i Ankandit të Dytë.....</i>	4
2.3.	Sqarimi i Procesit .....	4
	Zbulimi i kufijve të lejuar dhe dërgimi i Konfirmimit negativ Paraprak të NEMO-s.....	4
	Komunikimi me Anëtarët e Bursës.....	5
	Rihapja e librave të urdhërporosive .....	5
	Sesioni i Bashkimit të Tregut vazhdon normalisht por me orare të vonuara .....	5
2.4.	Përfundimi.....	5

## 1. Hyrje

Kjo procedurë përshkruan veprimtarinë e zakonshëm që duhet të zbatohet gjatë procesit të Bashkimit të Tregut në rast se çmimet e njëjës ose të të dyja zonave arrijnë ose tejkalojnë kufijtë e lejuar (të ulëta dhe/ose të sipërme) të dhëna në Tabelën 1 dhe Tabelën 2.

Brenda DAC, zonat e ofertimit për të cilat janë paracaktuar Kufijet e çmimeve janë:

*Tabela 1 – Kufijtë e çmimeve të paracaktuara të aplikueshme në Zonat e Ofertimit të DAC-it.*

Çmimet e shprehura në EUR	Lloji i Kufijve të Lejuar të Çmimeve të Ankandit të Dytë		Kufiri Minimal i Lejuar	Kufiri Maksimal i Lejuar
	Shqipëri	DAM	0	900
Kosovë	DAM	0	900	

Hapat teknikë të kësaj procedure nuk janë pjesë e procesit të DAC-it dhe trajtohen më tej në procedurat NEMO-Ofruesi i Shërbimit MC.

### 1.1. Përmbledhje

Ankandi i Dytë aktivizohet në rast se, të paktën një nga çmimet arrin ose tejkalon kufirin e lejuar të çmimeve, siç përmendet në Tabelën 1.

Procedura konsiston në rihapjen e librave të urdhërporosive të NEMO-ve për 10 minuta për t'u dhënë Anëtarëve të Bursës mundësinë të modifikojnë ofertat e tyre për të përmirësuar situatën e tregut.

Ofruesi i Shërbimit MC do të bëjë një llogaritje e dytë me versionin e ri të të Dhënave të Urdhërporosisë.

Në rast se çmimet në fjalë gjithsesi i arrijnë kufijtë e paracaktuar pas llogaritjes së Ankandit të Dytë, nuk do të ketë më një Ankand të Dytë të mëtejshëm.

### 1.2. Qeverisur / Rregulluar nga

- Marrëveshja Operacionale e Bashkimit të Tregut të Ditës në Avancë (DACOA)
- Rregullat dhe Procedurat e Tregut të NEMO-s

### 1.3. Mjetet

- Sistemi TI i Ofruesit të Shërbimit MC
- Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-s

### 1.4. Procedurat shoqëruese

Procedurat e mëtejshme:

- DAC\_NOR\_02: Rezultatet Përfundimtare MC

Procedura dhe rregulla të tjera të lidhura:

- DAC\_FAL\_01: Menaxhimi i Incidenteve
- DAC\_OTH\_02: Komunikimi i Brendshëm dhe i Jashtëm
- Procedura lokale
- Listat e kontrollit të punës së përditshme

## 2. Procedura

### 2.1. Parakushtet për të filluar

Sapo NEMO të marrë Rezultatet e Bashkimit të Tregut, NEMO bën kontrollet për të identifikuar nëse ndonjë nga kufijtë e çmimeve të lejuar është arritur/tejkualuar ose nëse ka ndonjë situatë reduktimi.

### 2.2. Pasqyrë e përgjithshme

Tabela e mëposhtme jep të gjithë hapat e përfshirë në zhvillimin e procedurës së Ankandit të Dytë. Procedurat e lidhura me DAC-n janë shënuar me gri, ndërsa procedurat lokale.

Tabela 2 – Procesi i Ankandit të Dytë

#	Procesi	Fillimi - Fundi	Nga	Tek	Mjetet
1	NEMO dhe Ofruesi i Shërbimit MC zbulojnë se kufijtë e lejuar të çmimeve janë arritur/tejkualuar në një ose të dyja zonat DAC.	Menjëherë (ASAP), sapo të merren Rezultatet e Bashkimit të Tregut			
2	NEMO dërgon një Konfirmim Paraprak negativ dhe informon menjëherë Ofruesi i Shërbimit MC.	ASAP (Sa më shpejt të jetë e mundur) - përpara se të Pranimin e Supozuar	Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-s	Ofruesi i Shërbimit MC	
3	NEMO merr një Konfirmim negativ Paraprak Global	ASAP (Sa më shpejt të jetë e mundur)	Ofruesi i Shërbimit MC	Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-s	
4	NEMO thërret IC	ASAP (Sa më shpejt të jetë e mundur)	NEMO	Ofruesi i Shërbimit MC	
5	NEMO merr komunikimin ALPEX_Exc_01: Kufiri i Lejuar është arritur – Rihapen librat e urdhërporosive.	ASAP (Sa më shpejt të jetë e mundur) pas vendimit NEMO	Ofruesi i Shërbimit MC	NEMO	
6	NEMO përcjell komunikimin ALPEX_Exc_01 tek EM dhe OST-të: Kufiri i Lejuar është arritur – Rihapen librat e urdhërporosive	ASAP (Sa më shpejt të jetë e mundur)	NEMO	Anëtarët e Bursës dhe OST-të	
8	NEMO mbyll librat e urdhërporosive	10 minuta pas kohës së rënë dakord për rihapjen			

### 2.3. Sqarimi i Procsit

#### Zbulimi i kufijve të lejuar dhe dërgimi i Konfirmimit negativ Paraprak të NEMO-s

*Duke qenë se hapat e zakonshëm të Ankandit të Dytë janë të detajuara në procedurat përkatëse të NEMO-s, më poshtë janë dhënë vetëm disa udhëzime të përgjithshme.*

Sapo NEMO përkatëse të marrë Rezultatet e Bashkimit të Tregut, është përgjegjësia e saj të kryejë kontrolle për të identifikuar nëse ndonjë nga kufijtë e lejuar përkatëse është arritur/tejkualuar.

Sapo NEMO zbulon arritjen/tejkalimin e këtyre kufijve, NEMO dërgon menjëherë një Konfirmim negativ Paraprak Global dhe informon Ofruesin e Shërbimit MC.

Skedari i Konfirmimit negativ Paraprak Global duhet të përmbajë arsyen përkatëse të refuzimit: “Janë arritur kufijtë e lejuar të çmimeve të Ankandeve të Dyta ose çmimi maksimale / kufizim”.

Ofruesi i Shërbimit MC gjeneron një Konfirmim negativ Paraprak Global për NEMO-n

#### **Komunikimi me Anëtarët e Bursës**

NEMO do të shpërndajë një komunikimin e jashtëm ALPEX\_Exc\_01: *Kufijtë e Lejuar janë arritur – Rihapen librat e urdhërporosive.*

Ky komunikim duhet të dërgohet në kohën e duhur në mënyrë që Anëtarët e Bursës të informohen përpara rihapjes së librave të porosive.

#### **Rihapja e librave të urdhërporosive**

NEMO-t mund të rihapin librat e tyre të urdhërporosive për Anëtarët e Bursës sipas orareve të rëna dakord dhe të komunikuar. Duhet të ketë gjithmonë 10 minuta kohë ndërmjet rihapjes dhe rimbylljes së librit të urdhërporosive.

NEMO dërgon të dhënat e modifikuara të urdhërporosive në Sistemin TI të Ofruesit të Shërbimit MC. Versioni i ri i të Dhënave të Urdhërporosisë do të ketë një vlerë të shtuar në krahasim me atë të mëparshmin.

NEMO nuk lejohet të dërgojë versione të reja të të Dhënave të Rrjetit gjatë një Ankandi të Dytë.

#### **Sesioni i Bashkimit të Tregut vazhdon normalisht por me orare të vonuara**

Sapo të merren versionet e reja të të dhënave të urdhërporosive në Sistemin TI të Ofruesit të Shërbimit MC, Sesioni i Bashkimit të Tregut do të vazhdojë normalisht, por me orare të vonuara.

### **2.4. Përfundimi**

Sapo të Dhënat e reja të Urdhërporosisë të dërgohen në Sistemin TI të Ofruesit të Shërbimit MC, do të fillojë llogaritja e dytë dhe do të ndiqen procedurat normale si zakonisht.